

**SHEMBULLI THJESHTON ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 5, DATË 26.10.2010
“PËR RREGULLAT THEMELORE NË LIDHJE ME MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE NË SISTEMIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR”.**

konkretisht, pika 2 dhe 12 që ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave shëndetësore nga
aksesi i paautorizuar i personave të tretë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në funksion të ushtrimit të detyrave funksionale, në zbatim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar ka realizuar inspektime në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, në një sërë institucionesh publike dhe private që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Rasti konkret i referohet kontrollit administrativ të ushtruar në dy subjekte kontrollues që ushtrojnë veprimtari në fushën e kujdesit shëndetësor.

Në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, përveç konstatimeve të tjera pranë këtyre kontrolluesve u evidentua se:

Kontrolluesit nuk kishin marrë masa të përshtatshme sigurie lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale që mbartnin përgjigjet e fletë analizave që kryhen në laboratorët e tyre (si: emri, mbiemri, tregues dhe rezultate të analizave, etj) për pacientet në procesin e shpërndarjes, duke mos i mbyllur përgjigjet e analizave në zarfë të veçanta për secilin pacient dhe pa marrë parasysh se kush ishte personi që bënte tërheqjen e rezultateve të analizave.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar rezultoi se përgjigjet e analizave laboratorike, nuk ishin të mbyllura, personat që do të merrnin përgjigjet e analizave të realizuara pranë këtyre institucioneve shëndetësore, paraqiteshin pranë recepsionit, dhe ky i fundit i dorëzonte personave që paraqiteshin (pa marrë parasysh nëse ky i fundit ishte pacienti ose jo) të gjitha fletët e analizave derisa të gjenin rezultatet përkatëse.

Në këtë mënyrë këta subjekte kontrollues nuk respektonin rregullat në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit shëndetësor, duke lejuar në mënyrë të paautorizuar dhe pa marrjen e pëlqimit të pacientit aksesin në rezultate analizash dhe duke bërë të mundur zbulimin e informacionit shëndetësor të persona të tretë të paautorizuar.

Kjo vjen në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr. 5, datë 26.10.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor” pika 2 dhe 12 ku parashikohet se:

Pika 2 a) Çdo pacient ka të drejtën themelore të privatësisë dhe konfidencialitetit të informacionit të tij shëndetësor.

b) Çdo pacient ka të drejtën e kontrollit mbi përhapjen e informacionit të tij shëndetësor, nëpërmjet dhënies ose tërheqjes së pëlqimit, të shprehur qartë.

Pika 12: Në lidhje me komunikimin (zbulimin) e informacionit të pacientit janë të detyrueshme rregullat si më poshtë: